| <p>këtij ligji dhe e mbron fshehtësinë dhe përdorimin e drejtë të të dhënave që ruhen në regjistrin e konsumatorëve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b><br/><b>Komisionet këshilluese të konsumatorëve</b></p> <p>1. Autoriteti nxjerr rregull, për Komisionin këshillues të konsumatorëve.</p> <p>2. Autoriteti themelon nga një Komision këshillues të konsumatorëve për secilën zonë të shërbimeve, në bashkërendim me komunën përkatëse dhe ofruesin përkatës të shërbimeve me qëllim të:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. konsultimit të konsumatorëve dhe dhënies së rekomandimeve Autoritetit për ndonjë çështje me rëndësi, përkitazi me ofrimin e shërbimeve;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. marrjes së vendimit lidhur me ankesat e shqyrtuara, të cilat nuk janë trajtuar si duhet nga ofruesi i shërbimeve;</p> <p>3. Autoriteti mbështet aktivitetet e Komisioneve këshilluese të konsumatorëve në aspektin material, financiar, administrativ dhe profesional.</p> | <p>kept at such Register of Customers.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b><br/><b>Customers' Consultative Committees</b></p> <p>1. The Authority shall issue a Rule for Customers' Consultative Committee.</p> <p>2. The Authority shall establish a Customers' Consultative Committee for each Service Area in coordination with the relevant Municipality, the relevant Service Provider for the purposes of:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. customer consultation and making recommendations for the Authority related to any important issue, respectively regarding the provision of services;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. the decision making regarding the reviewed complaints, which are not treated correctly by the Service Provider.</p> <p>3. The Authority supports Customer Consultative Committees activities in material, financial, administrative and professional aspect.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 26.</b><br/><b>Savetodavna komisija potrošača</b></p> <p>1. Autoritet donosi pravila, za Savetodavnu komisiju potrošača.</p> <p>2. Autoritet osniva po jednu Savetodavnu komisiju potrošača za svaku zonu usluga, u koordinaciji sa dotičnom opštinom i dotičnim pružaocem usluga, u cilju:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. konsultacije potrošača i davanja preporuka Autoritetu za neko važno pitanje, u vezi sa pružanjem usluga;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. donošenja odluke u vezi sa razmatranim žalbama, koje nisu tretirane kako treba od strane pružaoca usluga.</p> <p>3. Autoritet podržava aktivnosti Savetodavnih komisija potrošača u materijalnom, finansijskom, administrativnom i profesionalnom aspektu.</p> |
|---|--|--|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p><b>KAPITULLI V I<br/>SHKYÇJA NGA SHËRBIMET E UJIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 27<br/>Shkyçjet e ndaluara</b></p> <p>1. Autoriteti nxjerr rregull, për shkyçje,</p> <p>2. Asnjë ofrues i shërbimeve të ujësjellësit nuk mund të shkyç nga shërbimet asnjë person, përveç se në pajtim me kontratën e shërbimit sipas këtij ligji, apo rregullat e tjera lidhur me shkyçjet, të nxjerra nga Autoriteti. Ky ligj dhe rregullat e tjera të nxjerra nga Autoriteti mbizotërojnë mbi kushtet dhe dispozitat në kontratën e shërbimit në rast të kundërtshënive lidhur me shkyçjet.</p> <p>3. Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit nuk mund të shkyç ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit për objektin e personit të cenueshëm.</p> <p>4. Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit mund të bëjë ndërprerjen e shërbimeve nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. ka mendim të arsyeshëm se vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën a shëndetin e cilit do personi fizik;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.2. një ndërprerje e tillë kërkohet për qëllime operationale apo të mirëmbajtjes; ose</p> | <p><b>CHAPTER VI<br/>DISCONNECTION OF WATER SERVICES</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 27<br/>Prohibited Disconnections</b></p> <p>1. The Authority shall issue a Rule for disconnection.</p> <p>2. No Water Service Provider shall disconnect any Person, except in accordance with the Service Contract under this Law, or any other rules relating to Disconnections issued by the Authority. This Law and any rules issued by the Authority shall prevail over the terms and provisions in the Service Contract in case of controversy regarding the Disconnections.</p> <p>3. A Water Service Provider shall not disconnect the water service provided for residence of any Vulnerable Person.</p> <p>4. A Water Service Provider may Disconnect Water Services if:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. it is of the reasonable opinion that continuing to supply Water Services presents an immediate risk to the life or health of any natural person;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.2. such disconnection is required for operational or maintenance purposes; or</p> | <p><b>VI. POGLAVLJE<br/>ISKLUČENJE IZ USLUGA VODE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 27.<br/>Zabranjena isključenja</b></p> <p>1. Autoritet donosi pravilo za isključenje.</p> <p>2. Nijedan pružalac usluga vodovoda ne može da isključuje od usluga nijedno lice, osim u skladu sa Ugovorom za usluge prema ovom zakonu, ili drugim pravilima u vezi sa isključenjima, donetim od Autoriteta. Ovaj zakon i druga pravila doneta od Autoriteta prevladaju nad uslovima i odredbama u Ugovoru o usluzi u slučaju protivrečnosti u vezi sa isključenjima.</p> <p>3. Pružalac usluga vodovoda ne može da isključuje pružanje usluga vodovoda za objekat ugroženog lica.</p> <p>4. Pružalac usluga vodovoda može da vrši obustavu usluga, u koliko:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. postoji opravdano mišljenje da nastavak pružanja usluga vodovoda predstavlja neposredan rizik za život ili zdravlje bilo kog fizičkog lica.</p> <p style="padding-left: 40px;">4.2. takva obustava se zahteva u operationalne ili ciljeve održavanja; ili</p> |
|---|--|--|

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>4.3. kërkesa për ujë e tejkalon ofertën.</p> <p>5. Ndërprerjet e shërbimeve bëhen, në qoftë se janë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për largimin e rrezikut ndaj jetës apo shëndetit të personave të rrezikuar të shkaktuar nga ndërprerja e tillë dhe në rastin e paraparë në nënparagrafin 4.3. të këtij neni, që ndërprerje e tillë është bërë vetëm pasi që ofruesi i shërbimeve ka kursyer ujin në dispozicion në mënyrën më të mirë të mundshme në bazë të aftësisë së tij teknike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b><br/><b>Bazat për shkyçje</b></p> <p>1. Me kërkesë të konsumatorit, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit bën shkyqjen e shërbimeve të ujësjellësit të ofruara në përputhje me kontratën për shërbime për objektin ku banon konsumatori.</p> <p>2. Me kërkesë të konsumatorit, ofruesi i shërbimeve bën shkyqjen e shërbimeve të ujësjellësit të ofruara në përputhje me kontratën për shërbime për objektin pronë e të cilit është konsumatori, por që është i banuar nga personi tjetër, nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. banuesi është pajtuar se objekti mund të shkyçet, apo</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. është dërguar njoftim për shkyçje të objekteve të parapara për shkyçje në përputhje me paragrafin 1. të nenit 29 të</p> | <p>4.3. the demand for water exceeds supply.</p> <p>5. Service disconnections are done if all reasonable steps have been taken to eliminate the risk to the life or health of any vulnerable person caused by such disconnection and in the case foreseen under sub-paragraph 4.3. paragraph 4. of this Article, that such disconnection has only been done after the Service Provider has rationed the available water to the best of its technical ability.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b><br/><b>Grounds for Disconnection</b></p> <p>1. A Water Service Provider shall, upon the request of the Customer, Disconnect Water Services provided to premises occupied by the Customer in accordance with the Service Contract.</p> <p>2. A Service Provider shall, upon the request of the Customer, Disconnect Water Services provided in accordance with the Service Contract to premises owned by the customer, but occupied by another person, if:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. the occupant has agreed that the premises may be disconnected; or</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. a Disconnection Notice has been delivered to the premises to be disconnected in accordance with paragraph 1. of Article 29 of this Law.</p> | <p>4.3. potražnja za vodom prevazilazi ponudu.</p> <p>5. Prekidi usluga snabdevanja se vrše ukoliko su preduzete sve razumne mere za otklanjanje opasnosti po život ili zdravlje ugroženih lica, prouzrokovane od takve obustave i u slučaju predviđenim u osnovu 4.3. ovog člana, da je takva obustava izvršena samo nakon što je pružalac usluge štedeo vodu na raspolaganju na najbolji mogući način, na osnovu njegove tehničke sposobnosti.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28.</b><br/><b>Osnovi za isključenje</b></p> <p>1. Na zahtev potrošača, pružalac usluga vodovoda vrši isključenje usluga vodovoda, pruženih u skladu sa Ugovorom za usluge za objekat u koji potrošač stanuje.</p> <p>2. Na zahtev potrošača, pružalac usluga vrši isključenje usluga vodovoda, pruženih u skladu sa Ugovorom za usluge za objekat čiji je vlasnik potrošač, ali koji je nastanjen od drugog lica, ukoliko je:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. stanar saglasan da se objekat može isključiti, ili</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. dostavljeno obaveštenje za isključenje objekata predviđenih za isključenje, u skladu sa stavom 1. člana 29.</p> |
|---|--|---|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>këtij ligji.</p> <p>3. Ofruesi i shërbimeve mund ta shkyçë konsumatorin nëse:</p> <p>3.1. konsumatori ka shkelur kontratën e shërbimeve, me kusht që konsumatori të ketë qenë i njoftuar për shkeljen e tillë dhe që nuk ka bërë evitimin e saj brenda një kohe të arsyeshme të paraparë për atë qëllim;</p> <p>3.2. konsumatori nuk paguan faturën apo nuk hyn në marrëveshje për pagesë të faturës brenda një muaji kalendarik nga data kur ajo faturë duhet të paguhet;</p> <p>3.3. konsumatori nuk e bën pagesën e kërkuar në pajtim me marrëveshjen për pagesë pas njoftimit dhe pas mundësisë së arsyeshme për bërjen e pagesës së tillë;</p> <p>3.4. objekti është i kyçur në mënyrë të paautorizuara;</p> <p>3.5. konsumatori refuzon ta lejojë përfaqësuesin e ofruesit të shërbimeve, të identifikuar në mënyrë të duhur përmes kartelës me fotografi të tij, të ketë qasje në objektet e tij për të instaluar a lexuar njëhisorin apo për të inspektuar ose riparuar cilëndo pasuri të ofruesit të shërbimeve në objektet e konsumatorit;</p> <p>3.6. ekziston një rrjedhje e jashtme dhe e</p> | <p>3. A Service Provider may disconnect a customer if:</p> <p>3.1. the customer has violated the Service Contract, provided that the customer has been notified of such violation and has failed to remedy it within a reasonable period of time given for such purpose;</p> <p>3.2. the customer does not pay, or enter into a Payment Arrangement to pay an invoice within one calendar month of the date such invoice is due and payable;</p> <p>3.3. the customer did not pay the required payment, in accordance with the agreement for payment after the notification and after reasonable possibility for making of such payment;</p> <p>3.4. the premise is connected in unauthorized way;</p> <p>3.5. the customer refuses to allow a representative of a Service Provider, duly identified with a card bearing his or her photo, access to its premises to install or read a meter, or to inspect or repair any property of the Service Provider on the customer's premises;</p> <p>3.6. there is a visible, external leak on the customer's premises that the customer has not repaired, or has not made</p> | <p>3. Pružalac usluga može da isključi potrošača ukoliko:</p> <p>3.1. je potrošač kršio Ugovor o uslugama, pod uslovom da je potrošaču skrenuta pažnja na to kršenje i koji nije ništa preduzeo za njegovo otklanjanje u razumnom roku predviđenom za tu svrhu;</p> <p>3.2. Potrošač ne plati račun ili ne sklopi Sporazum o plaćanju fakture u roku o jednog kalendarskog meseca od dana kada ta faktura mora biti uplaćena;</p> <p>3.3. Potrošač ne izvrši traženu uplatu, u skladu sa Sporazumom o plaćanju fakture nakon obaveštenja i razumne mogućnosti za izvršenje takve uplate;</p> <p>3.4. je objekat neovlašćeno priključen;</p> <p>3.5. Potrošač odbija da dozvoli predstavniku pružaoca usluga, identifikovanom na odgovarajući način preko kartice sa njegovom fotografijom, pristup njegovim objektima, kako bi instalirao ili očitao vodomjer, izvršio inspekciju, popravku bilo koje imovine pružaoca usluga u objektima potrošača;</p> <p>3.6. postoji vidljivo spoljno procurivanje u objektu potrošača, koje potrošač nije popravio ili se nije</p> |
|---|---|---|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>dukshme në objektin e konsumatorit të cilën konsumatori nuk e ka riparuar apo nuk është marr vesh me ofruesin e shërbimeve për ta riparuar brenda pesë (5) ditëve të punës nga paraqitja e kërkesës me shkrim për ta bërë këtë ofruesi i shërbimeve;</p> <p>3.7. konsumatori nuk ka paguar paradhënien në datën e pagesës;</p> <p>3.8. ka baza të arsyeshme për të besuar se konsumatori ka shfrytëzuar shërbimet e ujësjellësit në mënyrë të pandershme;</p> <p>3.9. cilido person ka shfrytëzuar shërbimet e ujësjellësit të ofruara për konsumatorin për qëllim të paautorizuar;</p> <p>3.10. rrjeti i shpërndarjes së shërbimeve të ujësjellësit është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes së madhe ose të shkatërrimit;</p> | <p>arrangements with the Service Provider to have it repaired, within five (5) business days of being requested to do so in writing by the Service Provider;</p> <p>3.7. the customer has not paid the advance payment on the payment date;</p> <p>3.8. there are reasonable grounds to believe that the customer has obtained Water Services unfairly;</p> <p>3.9. any person has used Water Services supplied to the customer's premises for an unauthorized purpose;</p> <p>3.10. the Water Services distribution network is at an immediate risk of severe loss or damage;</p> | <p>dogovorilo sa pružaocem usluga o popravci u roku od pet (5) radnih dana od podnošenja pismenog zahteva da to uradi pružalac usluga;</p> <p>3.7. Potrošač nije uplatio avans na dan uplate;</p> <p>3.8. Ima razumnih osnova da se veruje da je potrošač na nepošten način koristio usluge vodovoda;</p> <p>3.9. Da je bilo koje lice koristilo pružene usluge vodovoda za potrošača u neovlašćenu svrhu.</p> <p>3.10. Distributivna mreža usluga vodovoda je u neposrednoj opasnosti velikog gubitka ili uništenja;</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b><br/><b>Procedurat e shkyçjes</b></p> <p>1. Njoftimi për shkyçje dërgohet në gjuhët zyrtare.</p> <p>2. Shkyçja bëhet nga së paku dy (2) punëtorë të ofruesit të shërbimeve të identifikuar siç duhet me një kartelë me fotografi të tij apo të saj.</p> <p>3. Shërbimi i ujësjellësit nuk shkyçet jashtë orarit të punës apo në ditën e cila nuk është ditë pune.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 29</b><br/><b>Procedures for Disconnections</b></p> <p>1. A Disconnection Notice shall be delivered in official languages of Kosovo.</p> <p>2. Disconnection shall be made from at least two (2) employees of service providers identified properly with a card with his or her photo on it.</p> <p>3. A Water Services shall not be disconnected during overtime or on the day which is not a working day.</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 29.</b><br/><b>Procedura isključenja</b></p> <p>1. Obaveštenje o isključenju dostavlja se na zvaničnim jezicima.</p> <p>2. Isključenje se vrši od najmanje dva (2) radnika pružaoca usluga pravilno identifikovanih putem kartice sa njegovom ili njenom fotografijom.</p> <p>3. Usluga vodovoda se ne isključuje van radnog vremena ili neradnim danima.</p>  |



|   |  |  |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b><br/><b>Kyçjet e paautorizuara</b></p> <p>1. Asnjë konsumator nuk mund të kyçet në mënyrë të paautorizuar.</p> <p>2. Ofruesi i shërbimeve mund të iniciojë procedurë penale në gjykatën kompetente ndaj cilitdo person fizik dhe juridik i cili ka kryer shkelje në bazë të Kodin Penal të Kosovës.</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 30</b><br/><b>Unauthorized Connections</b></p> <p>1. No Customer shall be unauthorizely Connected.</p> <p>2. A Service Provider may initiate the criminal procedures to a competent court against any natural or legal person who has committed violation under the Criminal Code of Kosovo.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 30.</b><br/><b>Neovlašćena prikljućenja</b></p> <p>1. Nijedan potrošač se ne može neovlašćeno priključiti.</p> <p>2. Pružalac usluga može da pokrene krivični postupak pri nadležnom sudu protiv bilo kog fizičkog ili pravnog lica, koje je izvršilo kršenje na osnovu Krivičnog zakonika Kosova.</p>  |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b><br/><b>Ri-kyçja e bërë nga ofruesi i shërbimeve</b></p> <p>1. Ofruesi i shërbimeve e ri-kyç objektin e konsumatorit jo më vonë se njëzetekatër (24) orë pasi që konsumatori të ketë paguar të gjitha shumat me kohë ndaj ofruesit të shërbimeve</p> <p>2. Cilado ri-kyçje e mëvonshme e objektit, qoftë me kërkesë të konsumatorit apo të ndonjë personi tjetër, trajtohet si kyçje e re dhe nuk e liron konsumatorin paraprak nga detyrimet, përkitazi nga shumat e papaguara ndaj ofruesit të shërbimeve.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 31</b><br/><b>Reconnection by the Service Provider</b></p> <p>1. A Service Provider shall reconnect the premises of a customer not later than twenty-four (24) business days, after such customer has paid all amounts due and payable to the Service Provider.</p> <p>2. Any subsequent re-connection of the premise, either at the request of the customer or any other person shall be treated as a new connection and does not relieve the customer from its obligations, in respect of unpaid amounts toward the Service Providers.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 31.</b><br/><b>Ponovno prikljućenje izvršeno od strane pružaoca usluga vodovoda i otpadnih voda</b></p> <p>1 Pružalac usluga vrši ponovno priključivanje objekta potrošača najkasnije dvadesetčetiri(24) sata nakon što potrošač bude blagovremeno izmirio sva dugovanja prema pružaocu usluga-</p> <p>2. Svako naknadno ponovno prikljućenje objekta, bilo na zahtev potrošača ili nekog drugog lica, tretira se kao novo prikljućenje i ne oslobađa prethodnog potrošača od obaveza, u vezi sa neisplaćenim iznosima prema pružaocu usluga.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b><br/><b>Rikyçjet e paautorizuara dhe manipulimi me ujmats</b></p> <p>1. Asnjë person tjetër përveç ofruesit të shërbimeve i cili e ka bërë shkyçjen e një konsumatori nga shërbimet e ujësjellësit, nuk ka të</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 32</b><br/><b>Unauthorized Reconnections and Manipulation with Water Meters</b></p> <p>1. No other person except the Service Provider who has made disconnection of customer to</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 32.</b><br/><b>Ponovna neovlašćena prikljućenja i manipulisanje vodomerima</b></p> <p>1. Nijedno drugo lice, osim pružaoca usluga, koji je izvršio iskljućenje jednog</p>   |

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>drejtë të bëj rikyçjen e atij konsumatori në shërbimet e ujësjellësit.</p> <p>2. Në rast se një konsumator pasi të jetë shkyçur nga shërbimet e ujësjellësit rikyçet në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni, ai konsumator do të konsiderohet si person i kyçur paligjshëm. Ofruesi i shërbimeve pas zbulimit të ri-kyçjes së paautorizuar do të zbatojë dispozitat e parapara me nenin 30 të këtij ligji, që janë të aplikueshme për kyçjet e paautorizuara.</p> <p>3. Asnjë person tjetër përveç ofruesit të shërbimeve nuk ka të drejtë të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet për matjen e ujit të konsumuar, qoftë ata të vendosur në sipërfaqe publike apo në objektin e konsumatorit.</p> <p>4. Në rast se një konsumator vepron në kundërshtim me paragrafin 3 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve ka të drejtë ta shkyç atë konsumator nga shërbimet e ujësjellësit dhe të iniciojë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.</p> <p>5. Ofruesi i shërbimeve ka të drejtë t'i faturojë atij konsumatori edhe dëmin financiar që vlerëson, pas konsultimit me Autoritetin se i është shkaktuar si pasojë e manipulimit me ujëmatës.</p> <p>6. Ofruesi i shërbimeve mund t'i konfiskojë të gjitha pajisjet për shërbimet e ujësjellësit, duke përfshirë të gjitha pajisjet për matjen e ujit të përdorura në objektet të cilat në vazhdimësi rikyçen në shërbimet e ujësjellësit në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.</p> | <p>Water Services, has a right to make re-connection of the customer in Water Services.</p> <p>2. If a customer is being disconnected from Water Services and is reconnected contrary to paragraph 1. of this Article, that customer shall be considered as unauthorizedly connected person. After Service Provider discovers unauthorized reconnection, shall implement the provisions set forth in Article 30 of this Law, which are applicable for unauthorized Connection.</p> <p>3. Any Person other than the Service Providers does not have the right to install and maintain the equipment for measuring the water consumed, those located in the public area or on the customers' premises.</p> <p>4. If a customer acts contrary to paragraph 3. of this Article, A Service Provider has the right to disconnect the customer from Water Services and to initiate judicial proceedings in a competent court.</p> <p>5. A Service Provider has the right after consultation with the Authority to invoice the customer with financial damage that estimates caused as a result of manipulation with water meters.</p> <p>6. A Service Provider may confiscate all equipment for Water Services, including all water measurement equipment used in facilities that continuously are re-connected in Water Services contrary to paragraph 1. of this Article</p> | <p>potrošača od usluga vodovoda, nema pravo da izvrši ponovno priključenje tog potrošača na usluge vodovoda.</p> <p>2. U slučaju da se potrošač, nakon što je isključen iz usluga vodovoda, ponovo priključi u suprotnosti sa stavom 1. ovog člana, on će se smatrati ilegalno priključenim. Nakon otkrivanja ponovnog neovlašćenog priključenja, pružalac usluga će primeniti odredbe propisane članom 30. ovog zakona, koje se primenjuju za neovlašćena priključenja.</p> <p>3. Nijedno drugo lice, osim pružaoca usluga, nema pravo da instalira i održava opremu za merenje potrošene vode, bilo one koja je postavljena na javnim površinama ili u objektu potrošača.</p> <p>4. U slučaju da potrošač postupi u suprotnosti sa stavom 3. ovog člana, pružalac usluga ima pravo da tog potrošača isključi iz usluga vodovoda i pokrene sudski postupak pri nadležnom sudu.</p> <p>5. Pružalac usluga ima prava da, nakon konsultacije sa Autoritetom, takvom potrošaču fakturiše finansijsku štetu koju proceni da mu je naneta, kao posledica manipulacije vodovodom.</p> <p>6. Pružalac usluga može da konfiskuje svu opremu za usluge vodovoda, uključujući i svu opremu u objektima korišćenu za merenje vode, koja se u kontinuitetu ponovno priključuje na usluge vodovoda, u suprotnosti sa stavom 1. ovog člana.</p> |
|--|---|---|

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b><br/><b>Tarifat dhe kompensimet për shërbime</b></p> <p>1. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë pagesën e tarifave dhe kompensimet për shërbime, në shumat e përcaktuara nga Autoriteti sipas urdhëresës tarifore të shërbimit.</p> <p>2. Në rastin kur ofruesi i shërbimeve nuk iu përmbahet procedurave të shkyçjes të parapara me nenin 29 të këtij ligji, ose me rregullat e nxjerra nga Autoriteti, çdo konsumator i prekur ka të drejtë për kompensim adekuat, siç përcaktohet kohë pas kohe nga Autoriteti.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 33</b><br/><b>Fees and Service Compensation</b></p> <p>1. A Service Provider may require the payment of fees and fees for services in amounts determined by the Authority under the service tariff order.</p> <p>2. In the event that a Water and Wastewater Service Provider fails to follow the disconnection procedures foreseen in Article 29 of this Law, or in the rules issued by the Authority, any affected Customer shall be entitled to receive adequate compensation as determined by the Authority from time to time.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 33.</b><br/><b>Tarife i nadoknade za usluge</b></p> <p>1. Pružalac usluga može da zahteva uplatu tarifa i nadoknada za usluge, u iznosu utvrđenim od Autoriteta, prema tarifinoj naredbi za usluge.</p> <p>2. U slučaju da se pružalac usluga ne pridržava procedura za isključenje, propisanih članom 29. ovog zakona, ili pravila donetim od strane Autoriteta, svaki oštećeni potrošač ima pravo na odgovarajuću nadoknadu, kako se povremeno utvrđuje od strane Autoriteta.</p>  |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b><br/><b>Ankesat e drejtuara komisionit këshillues të konsumatorëve</b></p> <p>1. Cilido konsumator i prekur nga shkyçja ndaj të cilit nuk është vepruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ose ndaj të cilit ofruesi i shërbimeve ka bërë shkelje të parapara në kartën e konsumatorëve dhe kontratën e shërbimit, mund ti parashtojë ankesë ofruesit të shërbimeve i cili ka bërë shkyçjen.</p> <p>2. Nëse konsumatori i cili i ka parashtruar ankesë ofruesit të shërbimeve në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, nuk beson që ankesa e tij është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme nga ofruesi i shërbimeve brenda një muaji kalendarik nga data kur kjo ankesë ka arritur tek ofruesi i shërbimeve,</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 34</b><br/><b>Appeal to Customers' Consultative Committee</b></p> <p>1. Any customer affected by a disconnection that has not been effected in accordance with the provisions of this Law, or that has been any other rights accorded under the Customers' Charter and the Service Contract violated by the Service Provider, may file a complaint to the Service Provider that effected such disconnection.</p> <p>2. If a customer who has made a complaint to a Service Provider pursuant to paragraph 1. of this Article, does not believe that its complaint has been satisfactorily resolved by the Service Provider within one calendar month of the date the complain reached the Service Provider, he</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 34.</b><br/><b>Žalbe upućene Savetodavnoj komisiji potrošača</b></p> <p>1. Svaki potrošač prema kome se prilikom isključenja nije postupalo u skladu sa odredbama ovog zakona, ili prema kome je pružalac usluga učinio povredu predviđenu Kartom potrošača i ugovoru usluga, može da podnese žalbu pružaocu usluga koji je izvršio isključenje.</p> <p>2. Ukoliko potrošač koji je podneo žalbu pružaocu usluga, u skladu sa stavom 1. ovog člana, ne veruje da je njegova žalba rešena na zadovoljavajući način od strane pružaoca usluga, u roku od jednog kalendarskog meseca, od dana kada je ta žalba dospela kod pružaoca usluga, u tom slučaju isti može da u pisanj</p> |

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>atëherë ai mund ta referojë çështjen me shkrim te komisioni këshillues i konsumatorëve që gjendet në zonën e shërbimit për ta zgjidhur.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b><br/><b>Marrëveshjet për pagesë</b></p> <p>1. Konsumatori i cili nuk ka paguar faturat që i ka borxh ofruesit të shërbimeve mund të kërkojë në përputhje me rregullat e nxjerra nga Autoriteti, që me ofruesin e shërbimeve të hyjë në marrëveshje për pagesën e faturave të tilla me këste, me kusht që konsumatori t'i paguajë të gjitha faturat e ardhshme që vijnë nga ofruesi i shërbimeve sapo që atyre t'iu vijë afati i pagesës.</p> <p>2. Nëse cilido këst i pagueshëm sipas marrëveshjes për pagesë nuk paguhet brenda një muaji kalendarik nga data kur duhet të paguhet kësti i tillë, e tërë shuma e papaguar sipas marrëveshjes për pagesë menjëherë bëhet e pagueshme përpos nëse ka masa të tjera për të cilat është arritur marrëveshja me konsumatorin për të kompensuar këtë mospagesë.</p> <p>3. Kushtet e secilës marrëveshje për pagesë, të cilën ofruesi i shërbimeve e jep, konfirmohen me shkrim dhe dërgohen në adresën e faturimit të konsumatorit brenda pesë (5) ditëve pune nga ofrimi i marrëveshjes së tillë.</p> | <p>may refer the matter in writing to the Customers' Consultative Committee located in the Service Area for resolution.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 35</b><br/><b>Payment Arrangements</b></p> <p>1. A Customer that has not paid invoices, which are due and payable to a Service Provider may request, in accordance with rules issued by the Authority, the Service Provider to enter into an arrangement for the payment in installments of such invoices, provided that the customer pays all future invoices from the Service Provider as soon as they become due and payable.</p> <p>2. If any installment payable under a Payment Arrangement is not paid within one calendar month of the date such installment falls due, the whole unpaid amount outstanding under the Payment Arrangement shall immediately become due and payable unless any other measures have been agreed with the Customer to remedy such default.</p> <p>3. The terms and conditions of any Payment Arrangement that the Service Provider has granted shall be confirmed in writing and delivered to the billing address of the customer within five (5) business days of the granting of such arrangement.</p> | <p>formi referiše pitanje kod Savetodavne komisije potrošača, koja se nalazi u zoni usluge, za rešavanje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 35.</b><br/><b>Sporazumi o plaćanju</b></p> <p>1. Potrošač koji nije platio fakture koje dužuje pružaocu usluga može da, u skladu sa pravilima donetim od strane Autoriteta, zahteva od pružaoca usluga da sklopi sporazum o plaćanju takvih faktura u ratama, pod uslovom da potrošač plati na vreme sve naredne fakture pružaoca usluga.</p> <p>2. Ukoliko se bilo koja uplativa rata prema sporazumu za uplatu ne bude uplaćena u roku od jednog kalendarskog meseca, od dana kada treba da se vrši uplata takve rate, sav neuplaćeni iznos prema sporazumu za uplatu postaje odmah uplativ, osim ukoliko postoje druge mere, za koje je postignut sporazum sa potrošačem za nadoknadu takve ne izvršene uplate.</p> <p>3. Uslovi svakog sporazuma o plaćanju, koje pružalac usluga daje, potvrđuju se u pisanoj formi i dostavljaju na adresu fakturisanja potrošača u roku od pet (5) radnih dana od pružanja takvog sporazuma.</p> |
|---|---|---|

| <b>KAPITULLI VII<br/>RAPORTIMI DHE MONITORIMI</b>   | <b>CHAPTER VII<br/>REPORTING AND MONITORING</b>  | <b>VII POGLAVLJE<br/>IZVEŠTAVANJE I NADGLEDANJE</b>  |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 36<br/>Raportimi</b></p> <p>1. Autoriteti mbledhë të dhëna dhe informata, duke mos u kufizuar vetëm në të dhënat financiare, operative dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të cilat i nevojiten për të ushtruar përgjegjësitë e tija sipas këtij ligji apo të ligjeve tjera të aplikueshme në vend.</p> <p>2. Ofruesit e shërbimeve duhet të dorëzojnë tek Autoriteti, raportet mujore, tremujore dhe vjetore me të dhëna, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara nga Autoriteti kohë pas kohe.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 36<br/>Reporting</b></p> <p>1. The Authority collects data and information, but not limiting to financial data, operational and customer services, that are needed to carry out its responsibilities under this Law or other applicable laws in the country.</p> <p>2. A Service Providers shall submit to the Authority monthly, quarterly and annual reports with data, under the format and deadlines set by the Authority from time to time.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 36.<br/>Izveštavanje</b></p> <p>1. Autoritet prikuplja podatke i informacije, ne ograničavajući se samo na finansijske, operative i podatke usluga prema potrošačima, koje su mu potrebne za obavljanje njegovih odgovornosti, prema ovom zakonu ili drugim primenjivim zakonima u zemlji.</p> <p>2. Pružaoci usluga treba Autoritetu da dostavljaju mesečne, tromesečne i godišnje izveštaje o podacima, prema obrascu i rokovima, povremeno utvrđenim od strane Autoriteta.</p>         |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 37<br/>Monitorimi</b></p> <p>1. Autoriteti në vazhdimësi bënë monitorimin e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e shërbimit të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji dhe pas verifikimit në vazhdimësi do t'i raportojë nivelet e shërbimeve të arritura gjatë periudhave të shikuara.</p> <p>2. Në mënyrë që të gjenerojë informacionin e kërkuar për monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së përbushjes së standardeve minimale të shërbimit, Autoriteti përcakton formatin që duhet</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 37<br/>Monitoring</b></p> <p>1. The Authority monitors continuously the services offered by Service Providers that should comply with the service standards set out in Article 21 of this Law, and after verification shall report continuously regarding the service levels achieved during the revised periods.</p> <p>2. In order to generate the information required for monitoring and evaluation of the accomplishment of the service minimum standards, the Authority shall present formats that should be reported by the Service Provider.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 37.<br/>Nadgledanje</b></p> <p>1. Autoritet u kontinuitetu vrši nadgledanje pruženih usluga od pružalaca usluga, koje moraju biti u skladu sa standardima usluge, utvrđenim članom 21. ovog zakona i nakon verifikacije, izveštavaće u kontinuitetu o stepenu ostvarenih usluga tokom perioda nadgledanja.</p> <p>2. Kako bi proizveo traženu informaciju za nadgledanje i ocenjivanje postizanja ispunjavanja minimalnih standarda usluge, Autoritet propisuje obrasce za podnošenje</p> |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>raportuar nga ofruesi i shërbimit.</p> <p>3. Autoriteti bënë monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve dhe të sektorit në përgjithësi, në mënyrë që të:</p> <p>3.1. sigurojë funksionimin efiçent të ofruesve të shërbimeve, dhe sektorit;</p> <p>3.2. përcaktoj nivelin në të cilin ofruesit e shërbimeve i përmbushin objektivat e përcaktuara përmes procesit tarifor;</p> <p>3.3. identifikojë veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme për të përmirësuar gjendjen.</p> <p>4. Për qëllim të monitorimit të performancës, Autoriteti përcakton:</p> <p>4.1. të dhënat edhe formatin e raportimit nga ofruesi i shërbimit;</p> <p>4.2. treguesit dhe metodologjinë më efikase për monitorimin dhe vlerësimin krahasues,</p> <p>4.3. treguesit kyç të performancës si dhe vlerëson peshën e tyre.</p> <p>5. Autoriteti publikon raporte periodike dhe vjetor të performancës, në të cilin shpaloset në hollësi vlerësimi i performancës siç është specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni.</p> | <p>3. The Authority monitors a performance of Service Provider and of the sector in general, in order to:</p> <p>3.1. ensure efficient operation of Service Providers and sector;</p> <p>3.2. determine the level to which Service Providers meet the objectives set by the tariff process;</p> <p>3.3. identify the corrective actions that may be necessary to improve the situation.</p> <p>4. In order to monitor the performance, the Authority shall determine:</p> <p>4.1. data and reporting format by the Service Provider;</p> <p>4.2. indicators and more efficient methodology for monitoring and comparative evaluation;</p> <p>4.3. the key performance indicators, as well as to assess their weight.</p> <p>5. The Authority publishes periodic and annual reports of performance, which unfolds in detail the performance evaluation as specified in paragraph 1. of this Article.</p> | <p>izveštaja pružalaca usluga.</p> <p>3. Autoritet vrši nadgledanje performanse pružaoca usluga kao i sektora uopšte, kako bi:</p> <p>3.1. Osigurao efikasno funkcionisanje pružalaca usluga i sektora;</p> <p>3.2. Utvrdio nivo na koji pružaoci usluga ispunjavaju objektivne utvrđene tarifynim procesom;</p> <p>3.3. Identifikovao korektivne postupke, koji mogu biti potrebni za poboljšanje stanja.</p> <p>4. U cilju nadgledanja performanse, Autoritet određuje:</p> <p>4.1. Podatke i obrazac izveštavanja od strane pružaoca usluge;</p> <p>4.2. pokazatelje i efikasnu metodologiju za nadgledanje i komparativnu procenu;</p> <p>4.3. Ključne pokazatelje performanse, kao i vrši procenu i njihove težine.</p> <p>5. Autoritet objavljuje periodične i godišnje izveštaje performanse, u kojima se detaljno predstavlja procena performanse, kao što je specifikovano u stavu 1. ovog člana.</p> |
|--|---|--|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 38<br/>Inspektimi</b></p> <p>Gjatë ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse, Autoriteti kryen inspektime përmes personave të autorizuar. Roli, kompetencat dhe detyrat e inspektorit në mënyrë më të detajuar do të rregullohen me akt të veçantë nga Autoriteti.</p> <p><b>KAPITULLI VIII<br/>DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE<br/>ADMINISTRATIVE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 39<br/>Dispozitat ndëshkimore</b></p> <p>1. Autoriteti do të nxjerr rregull për masat ndëshkuese.</p> <p>2. Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobë administrative nga njëzetmijë (20.000) deri në pesëdhjetmijë (50.000) euro nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. ofron shërbim pa pasur licencën për shërbim,</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. i ofron Autoritetit informata të falsifikuara, çorientuese, apo të pasakta duke ndikuar që Autoriteti të lëshojë a të përtëritë licencën për shërbim,</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 38<br/>Inspection</b></p> <p>In exercising its supervisory duties, the Authority carries out inspections by authorized persons. The role, competencies and inspectors' duties shall be regulated in more details with special act by the Authority.</p> <p><b>CHAPTER VIII<br/>PUNITIVE AND ADMINISTRATIVE<br/>PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 39<br/>Punitive Provisions</b></p> <p>1. The Authority shall issue a Rule for punitive provisions.</p> <p>2. A Service Provider shall be guilty of a violation and liable to pay an administrative fine from twenty thousand (20.000) up to fifty thousand (50.000) Euro if:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. provides a service without a Service License;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. supplies false, misleading, or inaccurate information to the Authority and thereby causing the Authority to issue or renew a Service License;</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 38.<br/>Inspekcija</b></p> <p>Tokom nadgledanja, Autoritet vrši inspekcije preko ovlašćenih lica. Uloga, nadležnosti i obaveze inspektora detaljnije će se regulisati posebnim aktom od strane Autoriteta.</p> <p><b>VIII POGLAVLJE<br/>KAZNENE I ADMINISTRATIVNE<br/>ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 39.<br/>Kaznene odredbe</b></p> <p>1. Autoritet će doneti pravila o kaznenim merama.</p> <p>2. Pružalac usluga je kriv za kršenje i obavezuje se da plati administrativnu novčanu kaznu od dvadeset (20.000) do pedeset hiljada (50.000) evra, ukoliko:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Pruža usluge bez posedovanja licence za usluge;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. daje Autoritetu falsifikovane, dezorijentirajuće ili netačne informacije, kako bi dobio ili produžio licencu za uslugu;</p> |
|--|--|---|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>2.3. nuk i respekton kushtet e licencës për shërbim të tij, apo të standardeve për shërbim dhe duke vepruar kështu shkakton rrezik për:</p> <p>2.3.1. shëndetin apo jetën e njerëzve,</p> <p>2.3.2. mjedisin, apo</p> <p>2.3.3. mjetet themelore të nevojshme për ofrimin e shërbimeve,</p> <p>2.4. furnizon me ujë të papërshtatshëm për përdorim nga njerëzit, ose</p> <p>2.5. Ndërprenë ofrimin e shërbimit pa ndonjë arsye të pranueshme për Autoritetin.</p> <p>3. Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobën administrative prej pesëmijë (5000) deri në njëzetmijë (20.000) euro nëse:</p> <p>3.1. përsërit apo shkelë në vazhdimësi obligimet e tij themelore të identifikuar dhe të parapara në rregullat e nxjerra nga Autoriteti në pajtim me këtë ligj, ose</p> <p>3.2. në mënyrë të paligjshme diskriminon cilindo person a grup të personave.</p> <p>4. Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje</p> | <p>2.3. breaches the conditions of its Service License or Service Standards and in doing so creates a serious risk to:</p> <p>2.3.1. human health of life;</p> <p>2.3.2. the environment; or</p> <p>2.3.3. assets needed for the provisions of services;</p> <p>2.4. supplies water unfit for human consumption; or</p> <p>2.5. abandons the provision of service without a cause acceptable to the Authority.</p> <p>3. A Service Provider shall be guilty of a violation and liable to pay an administrative fine from five thousand (5000) up to twenty thousand (20.000) Euro if it:</p> <p>3.1. repeatedly or persistently breaches its essential duties as identified and set out in rules issued by the Authority pursuant to this Law; or</p> <p>3.2. unlawfully discriminates against any person or group of persons.</p> <p>4. A Service Provider shall be guilty of a violation and liable for an administrative fine from one thousand (1.000) up to five thousand (5.000) Euro if it:</p> | <p>2.3. Ne poštujte uslove i standarde licence za uslugu i postupajući na takav način prouzrokuje štetu po:</p> <p>2.3.1. Zdravlje ili život ljudi,</p> <p>2.3.2. Životnu sredinu, ili</p> <p>2.3.3. Osnovna sredstva potrebna za pružanje usluga.</p> <p>2.4. Vršiti snabdevanje vodom koja nije za ljudsku upotrebu ili</p> <p>2.5. Obustavlja pružanje usluge bez nekog prihvatljivog razloga za Autoritet.</p> <p>3. Pružalac usluga je kriv za kršenje, obavezuje se da plati novčanu administrativnu kaznu od pet (5.000) do dvadeset hiljada (20.000) evra, ukoliko:</p> <p>3.1. Ponavi ili krši u kontinuitetu svoje osnovne obaveze, identifikovane i propisane pravilima donetim od strane Autoriteta, u skladu sa ovim zakonom ili</p> <p>3.2. Na nezakonit način diskriminiše bilo koje lice ili grupu lica.</p> <p>4. Pružalac usluga je kriv za kršenje i obavezuje se da plati novčanu administrativnu kaznu od jedne (1.000) do pet hiljada (5.000) evra, ukoliko:</p> |
|---|--|--|



|  |  |  |
|--|--|--|
